

BIBLIOTEKA

E

SH-1  
N.57

SHTETIT

GJIROKASTËR

ILIA NIKOLLA

# MBI UDHË E NËN UDHË...

poezi satir o-humoristike



SH-1  
NSF

ILIA NIKOLLA

MBI UDHË  
E NËN UDHË...

poezi satiro humoristike

~~8387~~  
14026\*

ILIA NIKOLIA

**Redaktor**

RAMAZAN VOZGA

*Ky vëllim ka fituar çmim të tretë në konkursin  
letraro-artistik të shpallur për nder të 40 vjetorit të  
themelimit të PPSH.*



## DY MBRETËR – NJË MBRETËRI

*Nga testamenti i mikrobit të malarjes*

...Me kosën e vdekjes ndër duar  
në fshat e qytet bëra hatanë;  
i vogël, gjithmonë i mallkuar,  
por lotët  
i sillja me shtambë...

Dhe kisha një mik aq të mirë,  
Ahmetin, s'u bëmë rivalë...

S'ma preku një qime mbretërinë,  
s'më hëngri në besë,  
në fjalë.

Sa thava me sporot e mia,  
si mbreti kur thante buxhetin;  
dy mbretër, dy kish Shqipëria:  
unë shëndetin,  
Zogu shtetin...

## NË PRAG TË VOTIMEVE


— Dëgjoni, millet! — e çeli prefekti, —  
ka ardhur t'ju flasë zotni deputeti.

— Zotërinj tregtarë, zanatçinj, fshatarë,  
kemi nja tre vjet që nuk jemi parë...  
Lart në parlament, nën hijen e mbretit,  
na lënë pa gjumë hallet e milletit.  
Ja, para një jave u vramë e u premë  
kur i rritëm Zogut me ligj hylefenë...<sup>1)</sup>  
Pa do thoni ju: «Ç'patët, pse u zutë?»  
Ka dhe deputetë që rrjedhin nga trutë,  
ngrihen dy a tre dhe prishin dynjanë  
për shkolla, spitale të derdhim paranë...  
Na qenkan të zgjuar... Kjo s'hahet hiç,  
pse, keq na ka dalë me hoxhë e me prift?  
Po të kemi mbretin të pasur, të fortë

---

1) rrogën (turq.)

nuk na gjen asgjë as sot e as mot;  
ndryshe nuk do bëjmë kurrë Shqipëri  
të qetë, të fortë, plot demokraci!



— Rroftë demokracia! Të na rrojë mbreti! —  
bërtiti sa mundi dhe vazhdoi prefekti:  
— Mot ta bëjmë prapë si radhën e parë  
që i dhatë votat me dru e xhandarë!...

## NJË XHANDAR RAPORTON PARA POSTKOMANDANTIT

— Sipas urdhrit që më dhatë  
shoqërova taksidarin;  
ai para, unë pas  
dhe në fshat e mbajtëm hapin.

Për drekë te kryeplaku  
me të ngrënë e me të pirë;  
hëngrëm sa s'na plasi barku,  
gjer këtu shkoi fare mirë...

Pasdite vumë tellallin  
me daulle lart e poshtë  
dhe e mblodhëm gjithë fshatin  
kë me hir e kë me forcë.

Sa nxorëm fjalën nga goja  
u ndez gjaku tek harbutët,  
na u sulën si ujkonja  
kush me hu e kush me sfurk...



Më kujtohen këto fjalë:

«Ne po vdesim nga uria,  
shpirti sa nuk na ka dalë, —  
dashka taksa qeveria!»

U lëshuan të tërbuar...

Unë u fsheha tek hendeku,

ish e kotë... që e shkruar...

Më rrëmbyen dhe dyfekun.

Pse mbahej harbut-fshatari?!

Vlojti huri e dajaku:

tutje zhdëpej taksidari,

pak më tutje kryeplaku.

Se ç'u bë më pas s'e di,

u përmenda në mesnatë...

Pamë tmerr e lemeri

dhe, me nder, na shkuan shtatë...



## TRI VAKTET E «DREJTËSISË» MBRETËRORE...

Ish «sekret» mbi çdo sekret,  
(sa e dinte dhe fëmija...),  
kur rronin përrallat me mbret  
kish tri vakte «drejtësia»:

Në drekë —  
    hapej biseda,  
në darkë —  
    hapej kuleta,  
në mëngjes —  
    vritej e drejta...

## NJË BISEDË NË AJODHIME

Psallti me një frymë  
mbërriti në ajodhimë,  
prifti ndërpreu meshën  
dhe fërkoj mjekrën.

— Oh, më fal, uratë,  
paç jetën e gjatë!  
Dhelpra në kotec,  
pulat janë keq...

— Për këtë prish gjakun?  
Hiqe pra merakun!  
Ja, po ndez temjanin  
ta përzë shejtanin.

Se lutjet e mia  
i qas perëndia;  
nuk jam dosido,  
prit edhe shiko!



— O, më fal, uratë,  
paç jetën e gjatë!  
Nuk u morëm vesh,  
e morëm rrebesh.

Më dërgoi priftëresha  
të të thoshja, desha:  
dhelpra s'më ra mua,  
janë pulat e tua...

Priftit iu prish gjaku,  
ungjillin e flaku:  
— Pse s'më the më parë  
ti, more trutharë?

Shpejt, të humbtë vula,  
se mbeta pa pula!...



## BABALLARËT E KOMBIT

Nuk lanë flamur pa tundur,  
xhepat e tyre plot flamurë,  
vetëm njërin e patën humbur,  
të atdheut s'e patën kurrë...

## NJË FUND I BUKUR

Dikur në këtë sallë  
mblidhej parlamenti,<sup>1)</sup>  
në role kukullash  
deputetët e mbretit.

Sot në këtë sallë  
mblidhen fëmijë:  
në fabul e në përrallë  
kukullat tani.

Parlamente të botës,  
ku lozet me kukull,  
një fund i tillë  
për ju është i bukur!...

---

1) Atje ku sot është Teatri i Kukullave në Tiranë dikur  
ka qenë parlamenti shqiptar.

## HESAPE PA HANXHINË

*Tetor, 1943*

Jashtë bëheshin beteja,  
brenda mblidhej «asambleja»;  
buzë më buzë me gjermanin,  
me një lugë pinin, hanin.  
«Baballarët» e dovetit  
vetulla i vinin «shtetit»,  
vetulla dhe lak në fyt,  
atdheut t'i nxirrnin sytë...

Tradhtia nxinte natë...  
Edhe djalli po të vinte  
s'do ta bënin jo, të gjatë:  
për të mirën e vatanit  
do ta shpallnin perandor,  
siç bëjnë me italianin,  
xhuxhmaxhuxhin Viktor...

Kur po putheshin në buzë  
populli u vari zile:  
u dërgoi «përfaqësues»  
nga Sauku disa... gjyle.



Thanë armiqtë pikë e vrer,  
kush me «zot», kush me «Hitler»,  
me vështrimin lart në re:  
— Janë gjyle apo... rrufe?!




## IKJE PA LAVDI

Agresorë,  
të shkuara, të paharruara!



Kaq herë e kini pësuar  
nga kjo tokë vullkan;  
kjo tokë  
as të vdekur nuk ju mban!  
I dëgjoni?  
Janë topat e fitores.  
Mos harroni:  
Erdhët  
duke nderuar me një dorë,  
po shkoni  
duke nderuar me... dy duart!



## FSHATARËT DJEGIN SHAMINË...

*Pranverë, 1945*

Reforma po shtrin litarët  
nëpër fusha, nëpër pllaja;  
djegin shaminë fshatarët,  
bejlerëve u bie damllaja...

Reforma po shtrin litarët,  
tokën merr kush e punon,  
çuçurisin çifligarët:  
«Kaq e pat dhe puna jonë!»

Festë e madhe popullore,  
bie daullja për lirinë...  
«Varri ynë — kjo fitore,  
ky litar është laku ynë!...»

Loti sa kokrra e fasules,  
agonia i pllakosi,  
larg goditjet e daulles  
u duken të shtëna topi...

## LARUSHJA ME NJË BRI

Unë, larushja me një bri,  
shoqeni, moj motrani,  
do t'ju them një histori,  
shoqeni, moj motrani!

Kam kaluar një rini  
porsi qyqe në vetmi,  
lidhur me litar të zi  
posht' e lart veç me fëmijë

sa më thyen dhe një bri,  
kur po haja grur' të ri...  
Plasi sherri me komshijtë  
sa nuk shkelnin në shtëpi.

Në gjykatë, në kryesi,  
shoqeni, moj motrani,  
nuk më mbeti nder në sy,  
shoqeni, moj motrani!

E pagova me një bri  
«ilegalin» ushqim të zi, —

malli i zhvatur, nuk e di,  
si s'ma thau këtë gji.

Bënim dëm në bujqësi,  
shoqeni, moj motrani!  
S'është përrallë, as çudi  
kjo që do t'ju them tani:

Qenkam lindur përsëri,  
tok me shoqe ha e pi,  
s'ka më mirë me shoqëri,  
plot shëndet, qumësht në gji!

Me bollëk, me pastërti,  
nëpër stalla — mrekulli,  
gjithë nder e krenari,  
shohim viçat drejt në sy.

Malli i ligjshëm — bukuri  
na jep gaz e gjallëri;  
tufëzimi — lumturi,  
pron' e vogël — helm i zi!

Thonë pleq, thonë fëmijë,  
edhe gratë me kusi,  
thonë burrat n'vllazëri:  
— Po ku ishim gjer tani?!



Po ju pres me dashuri,  
shoqeni, moj motrani,  
unë, larushka me një bri,  
shoqeni, moj motrani!

**NJË REFREN DIMËROR QË KËNDOHET  
GJITHMONË E MË RRALLË...**

O, ky fshati ynë  
mban dëborë shumë,  
kur ka borë e brymë  
s'dilet dot pa gunë...

Zbardhëllon natyra  
si një mullixhi,  
kush punon në zyra,  
kush në bujqësi.

Kurse ne të katërt  
këngë në konak,  
lozim, mu në vatër  
zjarri bubulak.

Na ke detyruar  
muhabet e gjumë,  
dimër, qofsh mallkuar,  
që na lë pa punë!

O, ky fshati ynë  
borë e derra shumë!  
Veç për derr mavrinë  
dalim dhe pa gunë...

Dalim dhe pa gunë  
herët nga shtëpia,  
por... një ditë në punë  
na ktheu rinia.

Kush e mban mbi supe  
atë fletërrufe?  
Si para e kuqe  
jemi bërë ne...

Pa zhurmë e pa krismë  
shpejt atje me shokë,  
të bëjmë qilizmë  
në mal e në kokë!...



## KOVAÇI NOVATOR

Kovaçin Dullë e hante merakun:  
diku në ndërmarrje puna nuk ecte,  
s'e zinte gjumi, i ziente gjaku  
mbi ca vizatime, mbi ca projekte.

Po ja, shef' i planit nuk e besonte  
e fjalë lëshonte «Po lodhet kot!»  
Kovaçin Dullë kjo e mundonte,  
por punën s'e la, besim kishte plot.

Dhe ja, një pasdite erdhi sukcesi,  
u dha rezultati, i qeshi xhani...  
E gjithë ndërmarrja e përshëndeti,  
e përshëndeti dhe... shefi i planit:

— A nuk të thashë «Jepi, Dullë,  
brumi që zure do bëhet kulaç!»

— Veç kulaçi im do mbetej qull  
sikur fjalëve të tua t'u vija saç...

## AUTOGOL!

Dola një ditë  
shkova në dyqan,  
bleva një pulovër  
ngjyrë jargavan.

Futa krahun brenda,  
bërryli doli jashtë:  
«Gërc!» — ia bëri mënga  
si të qe me kashtë.

M'u ndryshua çehrja,  
fort e prisha qejfin,  
vajta tek shitblerja  
dhe takova shefin:

— Ç'i thua kësaj?  
more, xhan vëllai?!  
Si më pa në sy  
nuk e bëri dy:

— Tek ne e ke blerë?  
Mos u bëj qeder!  
Eja, ndiqëm pas!  
— Ku?  
— Në trikotazh...

— Gjer këtu u lodhët? —  
i foli drejtori, —  
klienti që sollët  
është kontrollorN...

## ËNDRRA ME SY HAPUR

— Ku ka më mirë se shef...  
Je vetë zot, je vetë shkop,  
kërkon llogari (sa qejf!)  
nga zyra e ngrohtë, e ngrohtë.—

Ku ka më mirë se shef...  
Të rrihet në zyrë? Rri!  
Të dilet nga zyra? Dil!  
Të pihet kafe? Pi!

Ku ka më mirë se shef...  
Kur të thonë: «Shoku Iks!»  
er' e vartësve të deh,  
rakia është një hiç!

Të jem unë... unë shef!  
Pse s'më vënë veç një ditë?  
Ëndërroj... kam dhjetë vjet,  
veç askush nuk m'i hedh sytë.



— Të dëgjuam, na dëgjo:  
Me sy hapur ëndrra sheh;  
pikërisht veç për këto  
ti nuk bëhesh kurrë shef!

Klima jonë e shëndoshë  
ty të than edhe të shkrin,  
ndaj përherë ti në shoshë  
do të mbetesh si grashinë...

## NUK ECET PA FSHESE

*(Meditimet e një pastrueseje)*

Njëzet vjet që po fshin rrugën  
nënë Xheja, më e mira;  
fillon herët në agim,  
nuk lë qoshe të pafshira.

«Rrugët shpien, rrugët sjellin...  
A do të dënosh më rëndë?  
Lëre pa rrugë ti tjetrin —  
sikur e ke lënë pa këmbë...

Po si nuk na ra një shi,  
po si nuk pikoi një pikë?  
Po mbajtën rrugët pluhur  
të shpien në poliklinikë...

Si do ishte, vallë, jeta  
pa një rrugë, pa xhade?  
Le pastaj të mos ish fshesa:  
do të ecnim përmbi pleh...

Shumë gjëra dhe s'i di,  
por një gjë e di, për besë:  
pa rrugë në jetë s'ecet,  
si nuk ecet dhe pa fshesë!...»

## KUR MENDOHESH SADOPAK...

Shpesh përdorim ndër biseda  
aforizma pa kontroll,  
ca prej tyre unë desha  
t'i kaloj në sit' të hollë.

Të pickojnë porsi grera,  
sjellin dëm po u dhe hak,  
janë gjemba, janë ferra  
kur mendoresh sadopak...

*«Punë e mirë do gjashtë muaj,  
më e mira një vit thua!»*

(Mjegull fjalësh prej zyrtari,  
ku sot fshihet burokrati...)

*«Mos e lodh më atë gojë:  
ku ka rrjedhur, do pikojë!...»*

(Kështu thotë me durim  
liberali në kursim...)



*«Kur s'kam pula, pse patjetër  
të grindem me zonjën dhelpër?!»*

*(Kur s'i preket interesi  
kështu thot' mikroborgjezi.)*

*«Hë, de, hë s'u bë kiameti!  
Merr dhe ca se ka boll shteti...»*

*(Fjalë që s'i tha i urti,  
ferrë ku fshihet hajduti...)*

## SHPJEGIMI I FJALES «LËNG»

Lëng do të thotë:

Ujë, uthull, çervish, servil...

Merr formën e çdo ene:

të shishes, të gotës, të shefit...

Kur thyhet ena

hallakatet,

hapet;

kur transferohet shefi

trulloset,

nuk di nga të kapet.

Veç kur vjen shefi i ri

merr formë përsëri

si në fillim:

në familjen e lëngjeve

ky është i vetmi përjashtim...

## GJEZE

Me recetë nuk lëshohet, është tepër specifik, ish dikur i vyer shumë, nuk ta ndërronin me çiflig; ka dhe sot në radhë tona trutrazuar pors i llaç: ujë bëhen kur «sëmuren», e kërkojnë si ilaç...<sup>1)</sup>

---

1) Lexoni të lidhura shkronjat e para të çdo vargu

## QOFSH I KUJTDO QOFSH!

(Dy letra)

I

I dashur, baba!  
Nuk jam dhe aq mirë,  
fjala nuk më shkon,  
e kam të vështirë...

I dashur, baba!  
Jam mërzitur cazë,  
zbrit nja dy-tri ditë  
gjer këtu në bazë.

Të dalim një xhiro  
bashkë ne të dy:  
vetëm kaq kërkoj,  
Ç'të kushton kjo ty?

Pa do thonë ca:  
— I filanit ky?!

Pa do ndërrojnë gjuhë,  
pa do ndërrojnë sy...

## II

Biri im i dashur!  
Letrën e lexova  
dhe, për sa më shkruaje,  
çdo gjë e kuptova.

Kisha për të ardhur,  
tani nuk do vij:  
me këmbët e tua  
të bëhesh njeri.

Jeta të të rrahë  
me uthull, e vaj,  
mbështetu tek vetja  
dhe jo tek babai...

Tek ne ka një gjuhë,  
tek ne ka një sy,  
qofsh i kujtdo qofsh  
ato s'bëhen dy...

## ATY-KËTU

Sektorin e ke në ballë  
përmbi shokë, fare mirë!...  
Por si mund të harrosh, vallë,  
djalin tënd që të ka nxirë?

Dy-tri herë të kanë thirrur  
si në lagje dhe në shkollë,  
kurse ti u je përgjigjur:  
«Jam i zënë, nuk kam kohë!...»

Për tët bir të mos gjesh kohë?!  
Kjo s'përtypet, s'është parë...  
Po si bëjnë mijëra shokë  
që si ty janë baballarë?

Prandaj ndodh që nëpër mbledhje  
fjala jote pezull rri...  
— Pa shiko kush flet për sjellje,  
e harroi djalin e tij?!

Këto ishin disa fjalë  
që përmbledheshin shkurtimisht:  
si përgjegjës je në ballë,  
si baba qëndron në bisht...

## PËRGËNJESHTRIM!

Mbrëmë,  
kur muzgu nderi krahët,  
si çarçafët  
në ballkonet e fasadave,  
agjencia telegrafike e thashethemeve  
shpalli fejesën time  
në një rën nga lagjet e qytetit tim...





Sot në mëngjes  
analizova veten time gjer në intësi  
dhe konkludova:  
— Përgënjeshtim,  
unë asgjë nuk di!...

## DY PLATFORMA DASHURIE

— Do të vij, e dashur,  
do të vij atje,  
pritëm në dritare  
përmbi menekshe!

Mos mbaj rreth e rrotull  
lule ngjyraplot,  
se pastaj, e dashur,  
nuk të dalloj dot...

Të flasim për jetën  
dhe për dashurinë,  
për folenë tonë,  
për ditët që vijnë.

Ja, platforma ime:  
— Dashuri si zjarri,  
as punë shtëpie,  
as punë pazari!... —

— I dëgjova, «yll»,  
gjithçka që më the;  
mos të dukem, vallë,  
si një menekshe?

Ja, platforma ime:  
Të dy dorë për dore,  
unë edhe ti  
dhe jo zog i mbyllur  
brenda në kuvli...



## TI JE GRUAJA IME, PIKË

— Ti je gruaja ime, pikë!  
E përsëris, dëgjon Marika?  
Ti je gruaja ime, pikë,  
unë jam burri yt, dy pika:

E di, të pëlqen shoqëria  
me shokët e punës, kur vijnë,

por dije, konceptet e mia  
s'i bën dot ti relativë...

Dëgjo, mos ta zgjatim më shumë:  
meshkuj nuk dua për vizitë,  
si në shtëpi edhe në punë  
ti je gruaja ime, pikë!

— Jam jotja dhe ti je imi!  
E përsëris, dëgjon Petrika  
Jam jotja dhe ti je imi,  
dëgjomë edhe mua, tri pika...

E dija se s'kishe mustaqe,  
ato t'i paska mendimi,  
në do të rrojmë në paqe  
mos sill këtu Lekë Dukagjnin!...

## NDOSHTA ËSHTE RAST I RRALLE

Zura vend në fund të klasës,  
si dikur në bankën time,  
nxora letër edhe lapës  
nga komenti mbaj shënime:

«Ishte dimër... ju e dini,  
vargjet jan' fare të qarta:  
ishte data... ishte viti...  
ishte viti... ishte data...

Bënte ftohtë, siç e dini,  
plot me borë malet e larta...  
Ishte data... ishte viti...  
ishte viti... ishte data...

Dhe tani hapini sytë  
Luftë e Dytë përse plasi:  
Shkak i parë.. shkak i dytë...  
dhe i pesti... dhe i shtati...

Ishte viti... ishte data...  
ishte data... ishte viti...»  
Bie zilja, dal përjashta,  
nuk e fsheh: më mërziti...

— S'u kënaqe? — tha ai.  
— S'u kënaqa hiç dhe dije:  
unë prisja letërsi  
dhe jo orë historie... —

## **NJË NDRYSHIM I VOGËL...**

### **Imperializmi**

Kërkon fre për historinë,  
porsi ujku s'e do dritën,  
rend e rend për në greminë,  
të vret natën,  
të qan ditën...

### **Socialimperializmi**

Frerë do për historinë,  
drita thellë i kall datën,  
rend e rend për në greminë,  
të puñh ditën,  
të vret natën...





## TRAKTATI I VARSHAVËS

*Fjala e kryekomandantit të traktatit*

Përse u krijua s'ka rëndësi,  
kjo sot në mendje as që na shkon;  
e drejtë është ajo që na sjell dobi,  
qëllimi çdo mjet justifikon.

Të tjera ligje ka tani bota  
për hir «të mbrojtjes», të «integritit»,  
ju jeni zogjtë, unë jam kloçka,  
ndryshe kërدينë bën Perëndimi.

Do bëni ç'them unë... Ka vërejtje? S'ka!  
Do hani ç't'ju jap... Ka vërejtje? S'ka!  
Ju them «shëndet!», ju them edhe «plaç!»,  
se kloçka të jep kulaç e kërbaç...

Ju hyj pa trokitur, pa tak-tak,  
ju marr çfarë të dua tak-fak,  
ju thyej dhe kockat trak-trak,  
ndryshe nuk quhet më kot trak-tat!






## NE «TREGUN E PËRBASHKËT»

Po bie stërlina  
dhe marka e shkretë,  
po bie dollari,  
e gjora liritë!...

Dhe bëhet bilanci  
gjer natën vonë,  
kush është i pari,  
kush e pëson?


Kush zhvleftësohet,  
më tepër kush bie,  
kush është kampion  
për inflacion?

Të parët në listë  
zhvlerësohen çdo ditë  
vetë ministrat  
dhe qeveritë...



## KNER

— Urdhëroni, zotërinj, urdhëroni:  
makineri, naftë, bukë,  
lule dielli e mish derri,



ju garanton  
**KNER-i!**

Provojeni,  
do të mbeteni shumë të kënaqur,  
paçka se do vini me këpucë  
dhe do ikni... zbathur!

## GRAZHDI HRUSHOVIAN

Kur e panë se s'u ndezi,  
kur e panë se u plasi,  
kur e panë se PPSH-ja  
nuk u shkoi pas avazit,

— Do ta zëmë, — thanë ata, —  
do ta zëmë si laraskë,  
do të bëhet hata  
kur të bjerë, hop, në grackë... —

Isoxhinjtë me këmborë,  
me Gomulkë e kompani,  
kush si korb e kush si sorrë  
mbyllin sytë në kakarimë.

---

Mbyllin sytë në kakarimë  
mos harrojnë ndonjë fjalë:  
«Jepi, mbytja, siç e di,  
tra-la-la, zura një galë!



S'ka më armë, s'ka më luftë,  
doli luga prej floriri,  
ujq e dele në një tufë:  
dolën fjalët e ungjillit!»

I bekon së largu papa,  
ndez qirinj në Vatikan  
dhe në Moskë i nis të fala  
komunizmit hrushovian.

Hidhet zëri në tavan,  
hidhet vallja — këmba bosh,  
lehin larot «Ham, ham, ham!»  
me Zhivkov e Mogjorosh...

Gjeorgjevskaja lëngon,  
ç'është kjo hata e zezë!  
Hrushovi «filozofon»,  
gjeli po na bëka vezë...



## BETIMI I KAPITALISTËVE KINEZË KUR PRANOHEN ANËTARË TË PARTISË KOMUNISTE...

Betohem,  
për Tenin betohem,  
i ndritë shpirti kur të vdesë!  
Betohem,  
përgjërohem për socializmin kinez,  
Do ta mbroj  
pa rezervate,  
siç na mbron pronën private!...

## TË «RIEDUKUARIT»

Në oborrin  
e perandorit Pu Ji të Mançikuosë  
hyri një tigër  
fare pa qibër...

Perandori i gJORë,  
me citatet e Maos në dorë,  
ia dha me ulërimë  
dhe kapi telefonin për ndihmë.

— Mos u tremb, vëlla!

Nuk jam nga ata,  
nuk të ha;  
më kanë lëshuar  
nga që jam zbutur, riedukuar...

Perandori u qetësua,  
ëmbëlsisht filloi të qeshë:

— Po pse nuk thua?

Ne qenkemi kolegë... —



Pasi pinë nga një filxhan  
me çaj e uiski amerikan,  
në praninë e shërbëtorit  
tigri i tha perandorit:

— E mbarova afatin e riedukimit,  
jam në kulmin e gëzimit,  
dhe, që ta dish, o mik,  
nesër emërohem të luaj në cirk...

— Edhe unë, kështu si ti... —  
i tha perandori Pu Ji, —  
këto ditë jam në pritje:  
emërohem në një post  
me vendim të Byrosë së Përhershme

Politike...

## TRIPTIK EUROKOMUNIST

*Me gjuhën e fabulës*

### 1. Si u shkrua «Eurokomunizmi dhe shteti»...

*(Karriljo)*

Një zagar spanjoll  
shkoi në kasaphanë  
që të mbushte zorrët, —  
boll hëngri dynjanë.



Por kur shkoi ai  
s'gjeti asgjë shtruar...  
Fat i tij i zi,  
ditë e mallkuar!

Një sorrë trockiste  
me kujdes i tha:  
— Dale, përse ike?  
Pse nuk merr paça?

Zagarit si mokër  
barku nis t'i bluajë:  
— Por ç'e do, moj motër,  
nuk di ta gatuj...

— Ç'thua, mor vëlla?  
Shkruaj, mos e zgjat!  
Dhe sorra i dha  
gatimin paça...

Çdo presje, çdo pikë  
e mbajti shënim

dhe befas një ditë  
e botoi vëllim.

Dhe tundi dynjanë,  
dhe u ngjir nga mburrja —  
kështu për paçanë  
doli paçavurja...

## 2. Bretkosa Apologjete

(*Marshe*)

Bretkosa franceze,  
ndërsa mernte rreze,  
filloi të lëvdojë  
një gjarpër dalëbojë...

— Prit, bretkosë, prit,  
mos e merr me nxit,



mos na ngop me llafe,  
na jep prova, fakte!

Bretkosa s'e zgjati  
mori zjarr si zjarri:  
— Ka ndryshuar gjarpri,  
s'është më i pari.

Fishkëllim' e tij  
tamam melodi,  
mund të flesh mbi të,  
mund ta mbash në gjì...



Dhe, meqë s'doni llafe,  
po ju jap dhe fakte:  
shih po nxori zë  
kur t'i shkoj mbi të... —

Mori hov bretkosa  
me vrap, me nxitim,  
dhe i kaloi gjarprit  
mbi të fluturim.

— Jo kështu, bretkosë!  
Ti as që e preke,  
kështu nuk bën dot  
asnjeri për vete.

E bën dot një gjë?  
Pa shkeli mbi të!

— Meqë nuk besoni  
mua më vështroni! —  
Dhe u hodh me zjarr  
mbi gjarprin kular.

Po s'kaloi një çast  
dhe u vërvit lart,  
nga dhimbja e helmit  
tutje u përplas.

Tha, ndërsa përdridhej,  
(hajde, si në ballo!):  
— Jo, s'ka faj ai,  
i shkela në kallo!...

### 3. U nis cjapi të bëhet prift...

(*Berlinguer*)

Cjapit, kur iu rrit mjekra,  
iu rrit mendja edhe tha:

— Ose prift, o bëhet njëra,  
të më ndalë forcë s'ka! —

— Ikte rrugës me poza prifti,  
ikte rrugës fishkëllente

uvertura kompromisi,  
ndërsa ujku buzëqeshte:



— Ku kështu, o more cjan,  
kaq i qeshur, i gëzuar?  
Sikur marrë e ke me vrap... —  
i tha ujku shtruar-shtruar.

— Nuk e sheh që nga mjekra? —  
mburret cjepi gjuhëbrisk, —  
mjaft me rripa e me ferra,  
do të shkoj të vishem prift!


— Paskemi një udhë të dy, —  
thotë ujku dhëmbëjashtë, —  
edhe unë, ashtu si ti,  
do të shkoj të vishem papë... —

Edhe thosh me vete ujku,  
duke ecur, ashtu tok:  
«Në të lënça, bir kopuku,  
bëju ti edhe dhespot!»

— Die ersten vier in jeder  
— zweite vierzigste  
— alle die vier e in fünf  
— die die vier in vier

— Die ersten vier in jeder  
— die vier die vier  
— alle die vier e in fünf  
— die die vier in vier

— Die ersten vier in jeder  
— alle die vier e in fünf  
— die die vier in vier



## PASQYRA E LËNDËS

Dy mbretër — një mbretëri .....	3
Në prag të votimeve .....	5
Një xhandar raporton para postkomandantit .....	7
Tri vaktet e «drejtësisë» mbretërore .....	9
Një bisedë në ajodhimë .....	10
Baballarët e kombit .....	12
Një fund i bukur .....	13
Hesape pa hanxhinë .....	14
Ikje pa lavdi .....	16
Fshatarët djegin shaminë .....	18
Larushja me një bri .....	19
Një refren dimëror që këndohet gjithmonë e më rrallë .....	22
Kovaçi novator .....	24
Autogol! .....	25
Ëndrra me sy hapur .....	27
Nuk ecet pa fshesë .....	29
Kur mendohesh sadopak .....	31
Shpjegimi i fjalës «lëng» .....	33
Gjëzë .....	34
Qofsh i kujtdo qofsh! .....	35
Aty-këtu .....	37
Përgënjeshttrim! .....	39
Dy platforma dashurie .....	41
Ti je gruaja ime, pikë! .....	43

Ndoshta është rast i rrallë .....	45
Një ndryshim i vogël... ..	47
Traktati i Varshavës .....	49
Në «Tregun e përbashkët» .....	51
KNER .....	53
Grazhdi hrushovian .....	55
Betimi i kapitalistëve kinezë kur pranohen anëtarë të Partisë Komuniste .....	57
Të «riedukuarit» .....	58
Triptik eurokomunist .....	60
1. Si u shkrua «Eurokomunizmi dhe shteti» .....	60
2. Bretkosa apologjete .....	62
3. U nis çjapi të bëhet prift... ..	65

Nikolla, I.

Mbi udhë e nën udhë...

Poezi satiro-humoristike. [Red. R. Vozga],  
T., «Naim Frashëri», 1982

72 f. me il.

(B. m.) dhe

(B. v.): 891.983-1

N 57

Tirazhi 1500 kopje      Formati 70x100/32      Shtash: 2204-79

KOMBINATI POLIGRAFIK – Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1982